



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi Teksti**

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti i III, sem II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme: Studenti duhet të njohë konceptet kryesore dhe metodologjike të teorisë gjuhësore të ndryshme të cilat formojnë të ashtuquajturën *Gjuhësi Teksti*. Origjinat dhe synimet.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të përkufizohet dhe të përcaktohet termi *Tekst*.
2. Të njihen proceset dhe strategjitë gjuhësore nëpërmjet të cilave ndërtohet një njësi tekstore: koherenca; kohezioni ose përshtatja në lidhje me aftësitë gjuhësore.
3. Të identifikohen tipe të ndryshme tekstesh nëpërmjet karakteristikave specifike të tyre.

Rezultatet e pritshme:

1. Të arrijnë të zotërojnë njohuri të koncepteve të reja që do ti ndihmojnë studentët të aftësojnë kompetencat e tyre komunikuese dhe mbi të gjitha aftësinë e të shkruarit nëpërmjet analizës së teksteve të ndryshme. Ky proces do të zhvillohet pa lënë mënjane aftësitë e tjera gjuhësore.
2. Studenti duhet të zotërojë gjuhën spanjolle dhe të plotësojë korrektësisht kërkesat e kësaj lënde.
3. Të ketë njohuri mbi lëndët: *Tipologji I*, *Tipologji II* dhe *Tipologji III*